



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr.....pro.....

943/1

Date.....2025

07.02

URDHËR

Nr. 60, datë 07.02.2025

PËR

**SHPLLJEN E THIRRJES SË PARË PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE NGA PROGRAMET BUXHETORE “ARSIMI BAZË”, “ARSIMI I MESËM” DHE PROGRAMI “PËR ZHVILLIMIN E SPORTIT”, PJESË E PROGRAMIT PËR INFRASTRUKTURËN SHKOLLORE E SPORTIVE PËR PROJEKTET ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, si dhe Udhëzimit. Nr.9 datë 27.04.2022 “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin, bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e të infrastrukturës shkollore dhe sportive”,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve të reja, me cikël financimi 2025-2026, nga fondi i miratuar për vitin 2025-2026, për infrastrukturën shkollore e sportive, në programet buxhetore “Arsimi Bazë”, “Arsimi i Mesëm”, si dhe programi “Për Zhvillimin e Sportit”.
2. Drejtimit e thirrjes për financim:
  - a. Ndërtimi, rindërtimi dhe/ose zgjerimi i kapaciteteve të institucioneve/objekteve arsimore ekzistuese në arsimin bazë në kopshte dhe godina të shkollave, që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën fizike, me qëllim krijimin e kushteve të mjedisve dhe godinave arsimore në standarde evropiane për nxënësit dhe fëmijët që ndjekin arsimin në shkollat 9-vjeçare.
  - b. Ndërtimi, rindërtimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të objekteve arsimore ekzistuese në arsimin e mesëm të lartë, me qëllim krijimin e kushteve të mjedisve dhe godinave arsimore në standarde evropiane për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm të lartë.
  - c. Ndërtimi, rindërtimi dhe zgjerimi i kapaciteteve në objektet shkollore dhe mjediset sportive, palestrat sportive brenda apo jashtë godinave arsimore, duke financuar me përparë mjediset që shërbejnë si “Qendra Komunitare” apo qendra multifunksionale.
3. Vlera e bashkëfinancimit për çdo projekt nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), është përcaktuar sipas shtojcës I-rë, bashkëlidhur.

4. Cikli i financimit të projekteve për ndërtimin apo rindërtimin e objekteve arsimore është 2 (dy) vite buxhetore, përkatësisht viti 2025 dhe 2026, në varësi edhe me ecurinë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të projektit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Diferenca ndërmjet vlerës së projekti të miratuar ku përfshihet dhe bashkëfinancimi nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe vlerës të kontratës së nënshkruar, do të zbritet pjesës që do të financohet nga Ministria përgjegjëse për arsimin në vitin pasardhës.
5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat paraqesin më shumë se një aplikim, duhet të rendisin aplikimet e tyre, sipas prioritetit për financim.
6. Data e shpalljes së thirrjes për aplikim është data e publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencinë e Prokurimit Publik.
7. Aplikimi për financimin e projekteve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas shtojcave I, II e III , bashkëlidhur, realizohet brenda 30(tridhjetë), ditëve kalendarike nga data e publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
8. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, për të gjithë projektet e shpallur fitues, MAS do të njoftojë zyrtarisht NJVV-të.
9. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve, drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë e Prokurimit Publik.

**Ogerta MANASTIRLIU**

MINISTRI



## Shtojca I: VLERA E BASHKËFINANCIMIT PËR APLIKUESIT

Vlera e bashkëfinancimit për çdo projekt nga NJVV-të, është sa më poshtë:

- Për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) me popullsi nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera minimale e bashkëfinancimit nga NJVV të jetë në masën 15% të vlerës së plotë të projektit, alokuar për vitin korrent ose i përpjestuar për vitin pasues. (nëse projekti zbatohet në dy vite);
- Për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera minimale e bashkëfinancimit nga njësisë së vetëqeverisjes vendore, të jetë në masën 20% të vlerës së plotë të projektit, nga të cilat alokuar 10% për vitin korrent dhe 10% për vitin pasues (nëse projekti zbatohet në dy vite);
- Për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) me popullsi mbi 100 000 (njëqind mijë) banorë, vlera minimale e bashkëfinancimit nga ana NJVV, të jetë në masën 25% të vlerës së plotë të projektit, nga të cilat alokuar 15% për vitin korrent dhe 10% për vitin pasues (nëse projekti zbatohet në dy vite);

Diferenca ndërmjet vlerës së projekti të miratuar, ku përfshihet dhe bashkëfinancimi nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe vlerës të kontratës së nënshkruar, do të zbritet pjesës që do të financohet nga Ministria përgjegjëse për arsimin në vitin pasardhës.

### SHËNIM:

Ministria e Arsimit dhe Sportit, bazuar në të dhënat e INSTAT, kërkon pranë Ministrisë së Brendshme listën e të dhënave të vitit të fundit të banorëve sipas, njësisive të vetëqeverisjes vendore nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, njësisive të vetëqeverisjes vendore mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, si dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore mbi 100 000 (njëqind mijë) banorë.

## Shtojca II: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në faqen zyrtare të MAS dhe/ose "Agjencinë e Prokurimit Publik";	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve dhe afateve të thirrjes, sipas pikës 2 dhe 7 të këtij udhëri.
<b>30 ditë</b> kalendarike nga data e botimit në faqen zyrtare MAS dhe/ose Agjencinë e Prokurimit Publik	Aplikuesit/ njwsitw e vetwqeverisjes vendore,	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: Aplikimi i projektit nga NJVV , si dhe dosja e plotë e aplikimit në format të printuar si dhe kopje në CD, dërgohet me shkresë zyrtare më postë ose dorazi në protokoll-arkiv pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas afateve të përcaktuara në pikën 7 të këtij urdhëri.
<b>15 ditë</b> kalendarike nga afati i mbylljes së aplikimit	Komisioni i MAS	Vlerësimi i projekteve të aplikuara sipas shtojcës III, të këtij vendimi.
	Komisioni i MAS	Komisioni paraqet zyrtarisht pranë kryetarit listën e projekteve që propozohen për financim.



### Shtojca III: FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

#### Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	NJVV respektive
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet nga NJVV
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë MAS.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilën drejtim të thirrjes aplikohet (sipas drejtim të thirrjes së shpallur nga MAS).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të tij.
Data e mbarimit të projektit (*)	Të jepet data kur parashikohet të përfundojë projekti.
Përshkrimi i projektit (*)	<p>Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendndodhja e objektit të investimit: specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes;</li> <li>- Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt;</li> <li>- Përshkrimi i detajuar i punimeve/ndërhyrjeve që do të kryhen;</li> <li>- Standardi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në projektim;</li> <li>- Grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve;</li> <li>- Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij;</li> <li>- Për shkollat në fshatrat dhe/ose njësitë e qeverisjes vendore nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, aplikuesi paraqet informacion për numrin aktual dhe të pritshëm të nxënësve të shkollës, për të cilat kërkohet bashkëfinancimi, si dhe për shkollat dhe numrin e nxënësve në shkollat që gjenden në një distancë prej 4–5 km nga shkolla që kërkohet bashkëfinancimi, me qëllim optimizimin e mundësisë së investimit, përmes grupimit;</li> <li>- Risqet për zbatimin e tij;</li> <li>- Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse aplikohet), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj).</li> </ul>
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Sipërfaqe e trajtuar (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyrja projektit dhe nëse zhvillohet me faza apo lote.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje /lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	<p>Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij;</li> <li>- Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj;</li> <li>- Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.</li> </ul>

Fondet e kërkuara nga MAS(*)	Në rast se projekti nuk ka financim nga donatorë, kostoja/fondi që kërkoet është e barabartë me koston totale të projektit (në çdo rast, vlera të jetë me TVSH) minus vlerën dysheme të detyrueshme të bashkëfinancimit nga njësia e qeverisjes vendore, sipas shtojcës I të këtij udhëzimi.
Kontributi i detyrueshëm në bashkëfinancim nga njësia e qeverisjes vendore (*)	Aplikuesi e shoqëron aplikimin me një shkresë zyrtare, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë, ku merr përsipër së paku vlerën dysheme të bashkëfinancimit për këtë aplikim, të përcaktuar në shtojcën I të këtij udhëzimi. Aplikuesi mund të bashkëfinancojë një vlerë me të madhe sesa vlera minimale, nëse e shikon të mundur. Marrja përsipër e bashkëfinancimit nga aplikuesi, në, minimumi, vlerën minimale të tij të përcaktuar në shtojcën I, të këtij udhëzimi dhe paraqitja e shkresës që e konfirmon këtë është kusht detyrues për kalimin në fazën e vlerësimit të aplikimit dhe për (potencialisht) miratimin e financimit.
Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera e pritshme e donacionit në monedhën lekë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	<input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale)	<input type="checkbox"/> Po / <input type="checkbox"/> Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Deklarime (*)	Aplikuesi deklaron se: i. Projekti është gati për zbatim, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve. ii. Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioritetëve. iii. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar/siguron pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iv. Janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përlllogaritjen e koston dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikimit përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit; - preventivin; - grafikun e prokurimit dhe grafikun e zbatimit të punimeve; - relacionin teknik; - specifikimet teknike; - CD; - përlllogaritjet/parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit.

Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin jpeg ose .pdf
Pamje 3 Dimensionale (*) i detyrueshem	Imazhe në formatin jpeg ose .pdf

(\*) Fushat që kanë \* janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

**Shënim: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:**

1. Aplikimet për projekte, së bashku me dosjen e plotë të aplikimit në format të printuar dhe CD, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duhet të dërgohen me shkresë zyrtare nëpërmjet postës shqiptare, ose protokoll-arkive dorazi,
2. Format i aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.
3. Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyrimisht i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.
4. Nëse aplikuesi nuk merr përsipër vlerën dysheme të bashkëfinancimit të përcaktuar sipas shtojcës I, të këtij urdhëri, atëherë aplikimi nuk kalon në fazën e vlerësimit.